

REPUBLIKA E KOSOVË / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
 Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
 Ministria e Zhvillimit Ekonomik / Ministarstvo Ekonomskog Razvoja
 Ministry of Economic Development

Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No. 489
 Nr. Org. Org. Jodit. Org. Unit 01/3
 Nr. i faqëve / Broj stranica No. pages. -
 Data Datum Date 19.03.18
 PRISHTINË/A

KMDK SH.A Dalëse
 Hyrëse

Nr: 161/2018
 Data: 16.03.2018

Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë Sh.A
 Kosovo Landfill Management Company J.S.C
 Kompanija za Upravljanje Deponijama na Kosovu ĐĐ



Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë SH.A
Kosovo Landfill Management Company J.S.C
 Tel: 038 544 551, 544 552
 Adresa: Rr. Musine Kokollari -1 Dardani
 Prishtinë, Kosovë

Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë SH.A
Raporti Vjetor Financiar dhe Operativ 2017

Bordi i Drejtorëve në mbledhjen Dytë të Rregullt të vitit 2018 të mbajtur me datë 16/03/2018 njëzëri miratoi Raportin Vjetor 2017 të Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve dhe të Kryeshefit Ekzekutiv të NP KMDK SH.A, për Njësinë e Monitorimit të Ndërmarrjeve Publike, Ministria e Zhvillimit Ekonomik

	Kontrolloi	Aprovoi
Emri Mbiemri	Kryeshefi Ekzekutiv Z. Abdullah Haxhiu	Kryesuesi i BD Z. Lundrim Camaj
Nënshkrimi		
Datë	16/03/2018	16/03/2018



Përmbajtja	2
2. Raporti i Kryesuesit të Bordit të Drejtoreve	3
2.1. Aktivitetet dhe Performanca e Ndërmarrjes	3
a-Aktivitetet kryesore të ndërmarra gjatë vitit 2017.....	3
b-Pasqyra e performancës operative dhe financiare në krahasim me vitin paraprak.....	4
c-Ngjarje të cilat ndikojnë në të ardhmen e ndërmarrjes.....	7
d-Një pasqyrë e të priturve për vitin e ardhshëm sipas planit të Biznesit për vitin 2018.....	7
2.2. Informacione lidhur me kapitalin dhe dividenden	8
f-Kreditë e rëndësishme të nënshkruara apo të paguara gjatë vitit.....	8
g-Investimet e rëndësishme gjatë vitit 2017.....	8
gj-Dividendët e paguara gjatë vitit.....	8
2.3. Të dhëna për drejtorët jo-ekzekutiv	8
h-Emrat e drejtorëve të bordit, duke përfshirë kompensimet, shpenzimet dhe pagesat.....	8
i-Numri takimeve të Bordit gjatë vitit dhe numri pjesëmarrjes së drejtorëve në takime.....	9
j-Komitetet e Bordit, përbërja e tyre dhe numri takimeve të mbajtura.....	9
2.4. Informacione tjera-Raportimet të nevojshme për Aksionarin	9
k-Sponsorimet dhe donacionet.....	9
l-Raportet e auditorit të brendshëm.....	10
ll-Raporti mbi vetëvlerësimin e bordit të drejtorëve.....	10
2.5. Raportimet sipas Ligjit mbi Ndërmarrjet Publike	10
m-Pasqyra e Strukturës organizative të NP, Organogrami dhe Komentet.....	11
n-Shqyrtimi performancës afariste dhe financiare gjatë tremujorit Tetor-Dhjetor 2017.....	12
nj-Përmbledhja e procedurave gjyqësore gjatë vitit 2017.....	13
o-Përmbledhja e procedurave gjyqësore për 2018.....	14
p-Transaksionet e konsiderueshme që përfshin NP.....	15
q-Sugjerime dhe propozime për ndryshime të cilat me arsye pritet që ta rrisin performancën.....	15
3. Raporti i Kryeshefit Ekzekutiv	16
3.1. Hyrje.....	16
3.2. Ngjarjet kryesore të vitit.....	17
3.3. Pasqyre të performancës operative dhe rezultatet e indikatorëve kyç të performancës.....	18
3.4. Pasqyre të performancës financiare dhe rezultatet.....	23
3.5. Progresi me planin e biznesit.....	27
3.6. Shpenzimet kapitale dheprojekteve.....	28
3.7. Perspektiva për vitin e ardhshëm.....	28
3.8. Rreziqet e të ardhmes së korporatës.....	28

2. Raporti i Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve

Raporti i Kryesuesit të Bordit për vitin 2017, është përgatitur në emër të të gjithë Drejtorëve të Bordit të KMDK SH.A. Ky raport paraqet një pikëpamje gjithëpërfshirëse të detyrave ligjore, aktiviteteve dhe mbledhjeve të Bordit, si dhe vështirësitë më të cilat është ballafaquar Bordi i Drejtorëve dhe Menaxhmenti i KMDK SH.A gjatë vitit 2017, si dhe sfidat që na presin gjatë vitit 2018.

2.1. Aktivitetet dhe Performances e Ndërmarrjes

Në bazë të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë (KMDK SH.A) është Ndërmarrje Publike Qendrore, Kompani e legalizuar dhe është në procedure të rregullt për tu ri-licencuar, për Menaxhimin e Deponive Sanitare Regjionale të mbeturinave Komunale në Republikën e Kosovës, po ashtu është e regjistruar si Shoqëri Aksionare sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare Nr. 03/L-123.

Duke pasur parasysh natyrën e shërbimeve që ofron KMDK SH.A, ku ka të bëjë me pranimin e mbeturinave komunale për deponim, sidomos deponimin e mbeturinave shtazore të lejuar me Vendimin e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, pastaj asgjësimin e mbeturinave sipas kërkesës së Doganës së Kosovës, roli i KMDK SH.A është padyshim shumë i rëndësishëm në parandalimin e ndotjes së mjedisit, si dhe ka rol të rëndësishëm në ofrimin e shërbimeve cilësore për konsumatorët të cilët sjellin mbeturina në deponite e KMDK-se. Këtë rol KMDK SH.A e ushtron duke zbatuar legjislacionin në tërësi e sidomos legjislacionin mjedisor në veçanti, si dhe mekanizmat institucional që i ka në dispozicion, po ashtu duke u bazuar në realizimin e projeksioneve që kanë qenë të parapara me Planin e Biznesit 2017.

a-Aktivitetet kryesore të ndërmarrja gjatë vitit 2017

Aktivitetet e zhvilluar gjatë vitit 2017, kanë qenë në përputhshmëri me Ligjin për Ndërmarrjet publike, Ligjin mbi Shoqëritë Tregtare, Statutin e Kompanisë, Kodin e Etikës dhe Qeverisjes Korporative për NP-te Qendrore, si dhe me politikën e Aksionarit për NP-te, gjithnjë duke u kujdesuar për ruajtjen dhe rritjen e vlerës së aseteve të Kompanisë.

Aktivitetet kryesore të Bordit të Drejtorëve, kanë pas të bëjnë më hartimin e politikave, mbikëqyrjen dhe përkrahjen e Menaxhmentit të Kompanisë, ku ndër aktivitetet kryesore kanë qenë përgatitja e mbledhjeve të Bordit të Drejtorëve, qoftë të rregullta apo të natyrave tjera siç është Mbledhja e Përgjithshme Vjetor me Aksionarin, ku vlen të theksohet se Bordi vetëm gjatë vitit 2017 ka mbajtur 12 Mbledhje, 11 të Rregullta, si dhe 1 Mbledhje të Përgjithshme Vjetore me Aksionarin. Gjate këtyre mbledhjeve, sidomos të rregulltave kemi bere analizimin e raporteve financiare dhe operative lidhur me ecurinë realizimit të PB 2017, shqyrtimin dhe miratimin e raporteve tremujore, raportit vjetor financiar dhe operativ për vitin 2016, raportin e Auditimit për vitin 2016 të dhënë nga Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA), shqyrtimin dhe miratimin e Dhjetë Rregulloreve të Brendshme të Kompanisë, miratimin e Rishikimit të PB 2017, si dhe Planin e Biznesit për vitin 2018-2020. Po ashtu kemi ofruar dhe përkrahur politikën për Menaxhmentin duke nxjerr dhjetëra vendime konkretë, duke plotësuar rekomandimet e raportit të Auditimit të ZKA-se si dhe krijimin e kushteve që Kompania ti realizojë synimet e parapara sipas Planit të Biznesit 2017.

Duhet vënë në pah, se Bordi gjate gjithë punës se tij, i ka kushtuar rëndësi rritjes së inkasimit, uljes së shpenzimeve, dhe punëve ditore në operative. Madje kemi analizuar me kujdes edhe çështjen e Tarifës e cila është tejet e ulet, po ashtu edhe me rastin e ujerave të zeza në DS-Mirash, ku pas kërkesës dhe shqetësimit të Menaxhmentit, përmes mbledhjeve e kemi njoftuar Aksionarin për gjithë hapat ligjor që duhet ndërmarr sa ma urgjentisht. Punët e operativës nëpër Deponi kanë qenë aktivitetet parësor me të cilat është marr menaxhmenti dhe nuk ka munguar asnjëherë përkrahja e Bordit në këtë drejtim, krahas aktiviteteve për çështjet e financiare, ku ka rezultuar me rritje të shkallës së inkasimit dhe zvogëlim të (borxheve), detyrimeve financiare. Në fokus të aktiviteteve kanë qenë raportet me klientët si dhe angazhimet ditore të menaxhmentit dhe të përgjegjëseve të operativës në racionalizimin e shpenzimeve në të gjithë sektorët e KMDK-se, me përkushtim të theksuar për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e teknikes dhe infrastrukturës për qasje më të mirë në Deponi, si dhe mirëmbajtjen e makinerisë së rëndë të Ndërmarrjes për aktivitete dhe menaxhim cilësor të mbeturinave që pranohen për deponim. Gjithsesi, se pjesë e rëndësishme së veçante në KMDK, kanë qenë aktivitetet e Menaxhmentit lidhur me masat e marra për respektimin e ujdive-marrëveshjeve gjyqësore me KRM- të për kryerjen e borxheve të vjetra, gjë që

janë realizuar në mase të madhe, dhe fal këtyre marrëveshjeve, dukshëm është rritur inkasimi në vitin 2017, por normalisht nga të dhënat financiare shihet se akoma këto marrëveshje nuk janë përmbushur nga KRM-te me të cilat kemi ujdj gjyqësorë. Mund të konstatohet se janë realizuar në shkallë të pritur synimet e caktuara me PB.

b-Pasqyra e Performancës Operative dhe Financiare në Krahasim me vitin Paraprak dhe Aktual

Të dhënat e performancës dhe objektivat	2017	2016
Numri i klientëve të rregullt	45	38
Mbeturinat e hedhura ton	T- 280,332	T- 275,248
Faturimi	€ 1,557,553	€ 1,559,119
Inkasimi	€ 1,819,443	€ 1,842,914
Të ardhurat jo operative donacion, grande dhe subvencion	€ 577,927	€ 292,296
Shpenzimet në operim	€ 1,334,327	€ 1,272,352
Shpenzimet nga periudhat e mëhershme	€ 52,341	€ 30,890
Shpenzimet e borxhit te keq (Provizionim)	€ 13,276	€ 0
Shpenzimet e Zhvlerësimit (Amortizimit)	€ 595,879	€ 874,208
Llogaritë e arkëtueshme	€ 883,234	€ 2,776,337
Llogaritë e pagueshme	€ 295,968	€ 406,832
Paratë e gatshme dhe paratë ne banke	€ 67,655	€ 55,065
Shkalla e inkasimit (total)	116.8%	118%
Norma e mbulimit me punë	1.30	1.41
Norma e punës	1.11	1.20
Tarifa mesatare	5.31	5.31
Shpenzimet operative për ton	€ 7.12	€ 7.91

Mbeturinat e hedhura ton*

Të mbeturinat e amvisërisë (konsumuese) kemi rritje për 5,468 ton ose shprehur në % kemi 102 % rritje në krahasim me vitin 2016, ndërsa të mbeturinat tjera (jo konsumuese) kemi rënie për 383 ton ose shprehur në % kemi 76.24% apo rënie për 23.76%.

Faturimi*

Të të hyrat nga faturimi për mbeturinat konsumuese dhe jo konsumuese reflektohen nga sasitë e lartë shënuara të shprehura në vlerë me një rritje prej 10,152.00 Euro.

Po ashtu edhe të hyrat tjera (nga pranimet e materialeve demolative, dheu) kemi rënie për 11,414 Euro në krahasim me vitin 2016.

Gjatë vitit 2017 KMDK ka pasur realizim të faturimit për 99.90% në krahasim me vitin 2016.

Shpenzimet operative për ton në vitin 2017 janë 7.12 €, në krahasim me vitin 2016 kur shpenzimet operative për ton kanë qenë 7.91 €. Vlen të theksohet se sasia e mbeturinave të menaxhuara në vitin 2017 ka qene për 5,088 tonelata me e larte se sa në vitin 2016.

Shpenzimet e zhvlerësimit (amortizimit) janë në vlerë prej 595,879 Euro. Kjo ka ndodhë për shkak të rivlerësimit të jetëgjatësisë të Deponive nga ana e Komisionit të Kompanisë.

Performanca financiare e KMDK-se për vitin 2017, duke i përfshirë shpenzimet e përgjithshme si dhe shpenzimet e Zhvlerësimit (Amortizimit), Kompania nga të hyrat akruale dhe mbështetje me Subvencion nga ana e Aksionarit si dhe njohja e të hyrave të shtyra nga Donacionet dhe Grandet, del me një fitim para tatimit në korporatë prej 210,691 €.

Të dhënat krahasuese me caqet e Planit të Biznesit.

Shqyrtimi Performancës Afaristë dhe Financiare gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2017

Në Periudhën Janar-Dhjetor 2017 shkalla e Faturimit nga Planifikimi i Biznesit është 97.91%.

Në periudhën Janar-Dhjetor 2017 shkalla e Inkasimit nga Faturimi është 116.80 %.

Në periudhën Janar-Dhjetor 2017 shkalla e Inkasimit nga Plani i Biznesit është 85.94 % (duke përfshire edhe inkasimin e borxheve të vjetra). Norma e punës (Akruale i të ardhurave në operim/akruale i shpenzimeve operative dhe shpenzimeve tjera) në periudhën Janar-Dhjetor 2017 është 1.11.

Norma e mbulimit të punës (të ardhurat e operimit në kesh/shpenzimet aktuale të operimit) në periudhën Janar-Dhjetor 2017 është 1.30. Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2017 shpenzimet operative janë: (shpenzimet e amortizimit, shpenzimet operative, shpenzimet tjera / mbeturinat e hedhura) për ton janë 7.12 Euro

Të dhënat e performancës dhe objektivat	Vlerësimi performancës Janar-Dhjetor 2017	Projektimi performancës Janar-Dhjetor 2017
Numri i klientëve të rregullt	45	40
Mbeturinat e hedhura në Ton	t- 279,103	t- 278,721
Mbeturinat e hedhura nga mbetjet shtazore	t- 1,229	t- 1,820
Faturimi	€ 1,557,553	€ 1,591,008
Inkasimi	€ 1,819,443	€ 2,117,008
Të ardhurat jo operative grandet dhe subvencionet	€ 577,927	€ 752,506
Shpenzimet në operim	€ 1,334,327	€ 1,487,986
Shpenzimet nga periudhat e mëhershme	€ 52,341	€ 0.00
Shpenzimet e borxhit të keq (provizionimi)	€ 13,276	€ 0.00
Shpenzimet amortizimit	€ 595,879	€ 888,971
Llogaritë e arketueshme	€ 883,234	€ -
Llogaritë e pagueshme	€ 295,968	€ -
Paratë e gatshme dhe paratë në banke	€ 67,655	€ -
Shkalla e inkasimit (total)	116.8%	100%
Norma e mbulimit me punë	1.30	1
Norma e punës	1.11	1
Tarifa mesatare	5.31	€ 5.31
Shpenzimet operative për ton	€ 7.12	€ 5.31

Inkasimi*

Inkasimi i faturuar për vitin 2017 krahasuar me planin është përmbushë 95.08%, ndërsa inkasimi i borxheve me ri programim dhe procedura Gjyqësore dhe Përmbartimore është përmbushë vetëm 58.30%, arsye vonesat në vendosjen e këtyre lendeve nga organet kompetente.

Nga treguesit financiar sipas tabelës, shihet që KMDK SH.A ka përmbushur planin e të hyrave për vitin 2017 për 97.91%, ndërsa KMDK-ja ka realizuar inkasimin e faturimit të planifikuar për 95.08%, apo vetëm për 4.92% nuk është përmbush plani për vitin 2017, ndërsa inkasimi i borxheve me ri programim dhe procedura Gjyqësore dhe përmbartimore është përmbushë vetëm 58.30%, arsye vonesat në vendosjen e këtyre lendeve nga organet kompetente.

Kompania ka planifikuar të këtë Grande nga Buxheti i Kosovës për vitin 2017, mirëpo për shkak të shkurtimit të mjeteve buxhetore nga Qeveria e Kosovës, në këtë vit kemi realizuar vetëm 114,583 Euro Subvencione. Plani fizik i menaxhimit të mbeturinave në vitin 2017 nuk është realizuar për 208 tonelata, ose e shprehur në %, 0.07% apo plani është përmbushur për 99,93%.

Shpenzimet operative kane qenë me të vogla për 10.33% në krahasim me ato të planifikuara të vitit 2017. Llogarit e arketueshme janë paraqit në bazë të lejimit të provizionimit të borxheve të këqija të cilat kërkohen me standarde të kontabilitetit. Shpenzimet operative për ton në vitin 2017 janë 7.12 €, në krahasim me shpenzimet e planifikuara për ton në vitin 2016, të cilat kanë qenë 7.91 €, marr parasysh Tarifën tejet të ulet për deponim të mbeturinave.

c-Ngjarrje të cilat do mund të ndikojnë në të ardhmen e ndërmarrjes

Çështjet të cilat do mund të kishin ndikim në të ardhmen e KMDK-se janë:

Krijimi konditave më të volitshme në vazhdimësi të infrastrukturës së Deponive për klientët tanë, duke përfshirë përkrahjen me Grande nga Aksionari për Makinerinë e Rendë. Përmirësimi Raporteve afaristë me KRM-të. Zgjidhja e çështjes së obligimeve financiare të rregullta mujore të tyre. Realizimi i Marrëveshjeve në tërësi për Programimin e Borxheve të KRM-ve dhe të Borxheve të KMDK-së ndaj klientëve. Shkalla e inkasimit të të hyrave nga Klientët. Trajtimi i Ujërave të ndotura të Deponise në Mirash si dhe trajtimi, ndarja dhe selektimi i mbeturinave në të gjitha deponite dhe në Stacionin e Transferit, projekte këto që mund të realizohen vetëm me përkrahje nga Aksionari, e sidomos nëse Aksionari rrite tarifën e shërbimeve për deponim sipas praktikave të rajonit.

d-Një pasqyrë e të priturve për vitin e ardhshëm sipas planit të Biznesit për vitin 2018

Nga aspekti Potencialit për arritjen e Planit të biznesit në vitin 2018-2020, Kompania për Menaxhimin e Deponive, planifikon ngritje të mbeturinave për 9% në 4 Deponite Sanitare dhe në Stacionin e Transferit, mirëpo duhet pas parasysh se nëse fillon procesi i ndarjes në burim mund të mos realizohet kjo rritje, marr parasysh aktivitetet që janë duke u zhvilluar në disa komuna të Kosovës lidhur me ndarjen e mbeturinave ku KMDK shtrinë aktivitetin e saj. Nga aspekti aktivitetëve thelbësore të biznesit në vitin 2018, operacionet e duhura do jenë ato në favor të punëve të operative, nëpër deponi, si dhe për makineri dhe riparime të tyre, shpenzime këto të cilat do të mbulohen përmes kontratave ekzistuese në vazhdimësi. Punët eventuale shitesë për furnizim me shërbime do të jenë në bazë të procedurave të parapara ligjore. Me qëllim të sigurimit të cilësisë më të mirë të shërbimeve për klientët, KMDK-ja, do të veprojë në favor të ndërmarrjes së marrjes se masave të shpejta dhe efikase ndaj kërkesave të arsyeshme dhe nevojave tjera të klientëve. Nga aspekti i analizave financiare, gjatë vitit 2018, Kompania për Menaxhimin e Deponive do të orientohet drejt krijimit të profitit sa me të larte. Si ndërmarrje publike me tarifa aktuale, të gjitha përfitimet e mundshme ekonomike do ti takojnë drejtpërdrejt të gjitha komuniteteve të Kosovës. Kompania synon që të mbulojë të gjitha kostot operative të Ndërmarrjes, me përjashtim të amortizimit, me të ardhura nga paratë e gatshme. Nga aspekti i analizës së të hyrave, gjatë vitit 2018, KMDK-ja planifikon që të ngritë vazhdimisht të hyrat operuese nga klientët standard (kompanitë për grumbullim të mbeturinave) si dhe nga klientët e kontraktuar dhe klientët tjerë. Kompania do të ngarkojë koston e hedhjes së mbeturinave mbi kompanitë për grumbullim të mbeturinave dhe klientët tjerë privat, që do të thotë, se pagesat do të caktohen për të mundësuar kompaninë që të mbulojë kostot e plota për ofrimin e shërbimeve. Në periudhën vijuese, ngritja e shkallës së mbledhjes të të hyrave dhe mbledhja e borxheve nga vitet paraprake nga

KRM-të, se bashku me tentativat për menaxhim substancial dhe cilësor të mbeturinave, do të mbeten prioritetet më të larta për Bordin dhe Menaxhmentin.

KMDK-ja ka dy qasje kryesore për të ngritur inkasimin:

Krahas angazhimeve ditorë të Menaxhmentit të Kompanisë për krijimin e konditave të volitshme operative për klientët tanë, do të insistohet që përmes Marrëveshjeve në mes të KMDK-së dhe Kompanive Regjionale për Mbeturina, të ushtrohet një presion afarist mbi kompanitë grumbulluese të mbeturinave, që të paguajnë borxhet e vjetra dhe faturat aktuale mujore, ndërsa po që së dështon veprimi i sipërm, si opSION i fundit do jetë zgjidhja e kësaj çështjeje përmes Përmbarueseve Privat dhe Institucioneve Gjyqësorë.

2.2 Informacione lidhur me kapitalin dhe dividendin

f-Kreditë e rëndësishme të nënshkruara apo të paguara gjatë vitit

Kompania për Menaxhimin e Deponive KMDK SH.A nuk ka aplikuar për kredi gjatë vitit 2017.

g-Investimet e rëndësishme gjatë vitit 2017

- Investimet me mjete vetanake në makineri dhe infrastrukturë nëpër Deponite Sanitare regjionale:

1. Investimet në infrastrukturë në Deponite Sanitare regjionale	109,660
2. Investimet në riparimin në makinerinë e rëndë	70,513
3. Blerja e makinerisë së rend Buldozer për DS	169,280
4. Blerje e automjetit për nevoja të operatives (xhip-kamionët)	22,881
5. Furnizim me kontejner për mbeturina	21,296
6. Pajisje kompjuterike dhe inventar zyre	500
Totali i Investimeve me mjete vetanake (1 deri 6)	394,130

gj-Dividendë të paguara gjatë vitit

KMDK-ja, gjatë vitit 2017, ka realizuar një fitim para tatimit prej 210,691€.

2.3 Të dhëna për Drejtorët Jo-Ekzekutiv

Anëtarët e Bordit të Drejtoreshave të KMDK-se janë emëruar në bazë të vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

h-Emrat e drejtorëve të Bordit gjatë vitit, duke përfshirë kompensimet, shpenzimet dhe pagesat për shërbimet e ndërmarrjes, duhet theksuar se ky kompensim nga data 23/03/2016 ka ndodhur sipas Vendimit Nr. 07/81 të datës 23/03/2016 të Aksionarit (Qeverise).

Emri dhe Mbiemri	Pozita	Paga	Pjesëmarrje në Komitetet
Lundrim Camaj	Kryesues	450	Asnjë
Xhavit Hasani	Anëtar	320	80 Komisioni i Auditmit
Hafiz Krasniqi	Anëtar	320	110 Komisioni i Auditmit
Goran Laziç	Anëtar	320	Asnjë
Nexhat Berisha	Anëtar	320	Asnjë
Gazmend Bytyçi	Anëtar	320	80 Komisioni i Auditmit

i-Numri takimeve të Bordit gjatë vitit dhe numri pjesëmarrjes së drejtorëve në takimet e bordit `

Bordi Drejtoreve të KMDK-së, gjatë vitit 2017 ka mbajtur gjithsejtë 12 mbledhje, prej tyre 11 mbledhje të rregullta, dhe 1 Mbledhje të Përgjithshme Vjetore me Aksionarin.

Xhavit Hasani dhe Nexhat Berisha kanë marre pjese në 12 mbledhje, Lundrim Camaj, Hafiz Krasniqi dhe Goran Laziç kanë marr pjesë në 11 mbledhje, ndërsa Gazmend Bytyçi ka marr pjesë në 10 mbledhje.

j-Komitetet e Bordit, përbërja e tyre dhe numri takimeve të mbajtur

Komisioni i Auditimi, përbërja:

Z. Hafiz Krasniqi, Kryesues i KA, Xhavit Hasani dhe Gazmend Bytyçi, Anëtar

Komisioni i Auditimit ka mbajtur 11 mbledhje gjatë vitit 2017.

Komiteti për Staf dhe Shpërblime, përbërja:

Z. Nexhat Berisha, Kryesues, Z. Xhavit Hasani, Anëtar dhe z. Abdullah Haxhiu

Ky Komitet ka mbajtur një mbledhje gjatë vitit 2017

Komitetit për Monitorim dhe Emergjenca, përbërja:

Z. Lundrim Camaj, Kryesues, Z. Goran Laziç dhe Z. Abdullah Haxhiu, Anëtar

Komiteti për Buxhet dhe Financa, përbërja:

Z. Gazmend Bytyç, Kryesues, Z. Hafiz Krasniqi dhe Z. Abdullah Haxhi, Anëtar

Ky Komitet ka mbajtur një mbledhje gjatë vitit 2017

2.4 Informacione tjera

Raportimet e nevojshme për Aksionarin

k-Sponsorimet dhe donacionet-Subvencion kemi pranuar nga Aksionari 114,583 €.

I-Raportet e Auditorit të Brendshëm për vitin 2017

Raportet e Auditimit të Nëntor 2017
Raportet e Auditimit për Tremujoret (TM1, TM2, TM3) 2017
Raporti i Auditimit të Arkës Janar-Mars 2017
Raporti i Auditimit të Hyrave Janar-Shtator 2017
Raporti i Auditimit të Pagave Janar-Qershor 2017
Raporti i Shpenzimeve Operative Janar-Shtator 2017
Raporti i Shpenzimeve të Naftës Janar-Shator 2017
Raporti i Aktiviteteve të Shërbimit të Prokurimit Janar-Tetor 2017
Raporti i Auditimit sipas kërkesës së Komisionit të Auditimit
Raporti i Auditimit të Shpenzimeve të Mirëmbajtjes Tetor 2017
Raporti i Auditimit të Aseteve të Kompanisë


II-Raporti mbi Vetëvlerësimin e Bordit të Drejtorëve, është pjesë përbërëse e këtij Raportit Vjetor 2017.

2.5 Raportimet sipas Ligjit mbi Ndërmarrjet Publike

m-Pasqyra e Strukturës organizative të NP, Organogrami dhe Komentet

KMDK SH.A ka strukturën e saj organizative në përputhje me Ligjin Nr.03/L-087, që përbëhet nga Bordi Drejtorëve si organ mbikëqyrës i cili emërohet nga Aksionari po ashtu edhe nga Komisioni i Auditimit i cili përbëhet nga tre anëtarë që janë pjesë e Bordit të Drejtorëve por që emërohen nga Ministri i MZHE-se. Me qëllim të menaxhimit më eficient dhe efektiv, BtD gjatë vitit 2017 ka aprovuar strukturën organizative konforme **Rregullores Nr. 01/2017 për Procedurat e Punësimit, Strukturën Organizative, Kategorizimin dhe Përshkrimin e Vendeve të Punës në KMDK SH.A.** Bazuar në nenin 5 të Rregullores së lartpërmendur KMDK SH.A ka këtë strukturë organizative: Bordi emëron tre zyrtarët e lartë (KE-ne, ZKFTH-ne dhe SK-in) kurse AB e emëron Komisioni i Auditimit. Kryeshefi Ekzekutiv është pozita më e rëndësishme në ndërmarrje ngase është përgjegjës për menaxhimin e ndërmarrjes, angazhimin e burimeve korporative me qëllim realizimin e synimeve dhe objektivave strategjike të përcaktuara me PB dhe për punën e tij i përgjigjet drejtpërsëdrejti Bordit të Drejtorëve. Strukturën tjetër menaxheriale të ndërmarrjes e përbëjnë ZKFTH, Drejtoria e Operativës, Drejtoria e Administratës, Drejtoria e Prokurimit, Menaxheri i Sistemit të Cilësisë, Menaxherët e Deponive si dhe Udhëheqësit e Njësive. Me Rishikimin e Planit të Biznesit 2017, janë të parapara gjithsej **94** vende punë në KMDK SH.A, pozita këto të paraqitura në Organogramin e PB.

Në fund të vitit 2017 KMDK SH.A ka gjithsejtë 82 punëtorë.



- ZKFTH** - Zyrta e Kryeshefit Financiar dhe i Thesarit
- AB** - Auditori i Brendshëm
- NjKBI** - Njësia e Kontrollës së Brendshme Inspektuese
- Z. e KE** - Zyra e Kryeshefit (Zëdhënësi/ja Asistenti/ja dhe Shoferi Personal)
- PPSH&S** - Personi Përgjegjës për Shëndet dhe Siguri
- MD** - Menaxherët e Deponive
- SI** - Spektori i Inxhinierisë
- NJT** - Njësia Teknike
- NJMM** - Njësia për Mbrojtjen e Mjedisit

n-Shqyrtimi Performances Afaristë dhe Financiare gjatë Tremujorit Tetor-Dhjetor 2017

Në Periudhën Tetor-Dhjetor 2017 shkalla e Faturimit nga Planifikimi i Biznesit është 93.81%.

Në periudhën Tetor-Dhjetor 2017 shkalla e Inkasimit nga Faturimi është 150.80 %.

Në periudhën Tetor-Dhjetor 2017 shkalla e Inkasimit nga Plani i Biznesit është 98.47 % (duke përfshirë edhe inkasimin e borxheve të vjetra). Norma e punës (Akruali i të ardhurave në operim/akruali i shpenzimeve operative) në periudhën Tetor-Dhjetor 2017 është 1.12.

Norma e mbulimit të punës (të ardhurat e operimit në kesh/shpenzimet aktuale të operimit) në periudhën Tetor-Dhjetor 2017 është 1.70. Gjatë periudhës Tetor-Dhjetor 2017 shpenzimet operative janë: (shpenzimet e amortizimit, shpenzimet operative / mbeturinat e hedhura) për ton janë 4.79 Euro.

Aneks1

Të dhënat e performancës dhe objektivat	Vlerësimi i performancës Tetor-Dhjetor 2017	Projektimi i performancës Tetor-Dhjetor 2017
Numri i klientëve te rregullt	40.00	40.00
Mbeturinat e hedhura në ton	69,552.00	71,060.00
Mbeturinat e hedhura nga mbetjet shtazore në ton	120.00	455.00
Faturimi	375,335.00 €	400,081.00 €
Inkasimi	566,128.00 €	574,938.00 €
Të ardhurat jo operative	70,924.00 €	0.00 €
Të ardhurat jo operative, Subvencioni	114,583.00 €	0.00 €
Të ardhurat jo operative, Grandët pjesa e vitit 2017	29,188.00 €	29,188.00 €
Shpenzimet në operim	281,263.00 €	344,654.00 €
Shpenzimet tjera jo operative të periudhës se mëhershme	52,341.00 €	0.00 €
Shpenzimet amortizimit	(22,502.00) €	222,243.00 €
Llogarite e arketueshme	2,472,692.00 €	0.00 €
Llogarite e pagueshme	295,338.00 €	0.00 €
Paratë e gatshme dhe paratë në banke	67,655.00 €	0.00 €
Numri i të punësuarve	82	94
Shkalla e inkasimit (total)	98.47%	100%
Norma e mbulimit me punë	1.70	1.00
Norma e punës	1.12	1.00
Tarifa mesatare	5.31 €	5.31 €
Shpenzimet operative për ton	4.79 €	5.31 €

nj- Përmbledhja e procedurave gjyqësore gjatë vitit 2017

Gjatë vitit 2017, kanë vazhduar proceset gjyqësore në kontestet e borxheve që kemi ndaj disa operatoreve ekonomik të cilët na kane paditur dhe kontestet me klientët tanë ndaj të cilëve kemi ushtruar padi që kanë të bëjnë po ashtu me borxhet që na detyrohen sipas kontratave që kemi lidhur me ta në bazë të legjislacionit në fuqi. Përveç kontesteve të borxheve kemi edhe kontestet e punës. Kontestet gjyqësorë do të renditen si në vijim:

Padite që kemi ushtruar pranë gjykatave kompetentë ndaj klientëve dhe ish-kontraktoreve tanë, kane vazhduar edhe në vitin 2017. Ndaj **KRM "Pastrimi"** për shumën e borxhit 1.408,392,89 €, janë zhvilluar disa seanca, kemi prezantuar provat, gjykata ka kërkuar negocim mes palëve lidhur me riprogramimin e borxhit, mirëpo përfaqësuesit e KRM Pastrimi nuk kanë shprehur interesim dhe kanë kërkuar ekspertizë financiare për barazimin e borxheve. Në kemi pranuar raportin e ekspertit ku është konstatuar borxhi që ka KRM "Pastrimi" ndaj nesh në vlerë 1,394,449.65 €. Gjatë vitit kemi mbajtur disa seanca ku kemi përfunduar edhe shqyrtimin kryesorë dhe pas kërkesës së gjykatës ne kemi dorëzuar fjalën përfundimtare dhe kemi pranuar aktgjykimin e Gjykatës i cili është në favor tonin, KRM "Pastrimi" është ankuar në Gjykatën e Apelit. Gjykata e Apelit e ka kthyer lenden në rigjykim me arsyetimin se një pjesë e borxhit deri në 2009 gjoja është parashkruar, janë mbajtur disa seanca dhe prape Gjykata Themelore ka vendosur në favorin toni, Pastrimi prape është ankuar në Apel dhe presim si do vendos Apeli. Kurse kemi ushtruar edhe Propozime për Përmbarrim për shumën e borxhit që kane mbetur mbas padisë. Këto propozime janë dërguar përmes Përmbarruesve Privat për KRM "Pastrimi" në vlerë 176,135.17 Euro, "Pastrimi" ka ushtruar prapësim dhe nga Gjykata kemi një Aktvendim ku e kane përcjell lenden në Departamentin e Përgjithshëm-Divizioni Civil, Prishtinë, ngase Departamenti Ekonomik është shpallur jo kompetente, Gjykata ja ka refuzuar prapësimin dhe i ka kërkuar **KRM "Pastrimi"** të paguaj garancinë shumën për të ushtruar Ankesën në Gj. Apelit, ata kanë paguar garancinë dhe lende është në Gj. Apelit.

Kurse kundër **KRM Pastërtia**, Ferizaj kemi ushtruar edhe Propozime për Përmbarrim për shumën e borxhit që kane mbetur mbas padisë. Këto propozime janë dërguar përmes Përmbarruesve Privat për KRM "Pastërtie" në vlerë 193,533.22 Euro. "Pastërtia" ka ushtruar prapësim dhe nga Gjykata kemi një Aktvendim ku e kanë përcjell lenden në Departamentin e Përgjithshëm-Divizioni Civil, në Gjykatën e Ferizajt, ngase Departamenti Ekonomik i GJ. Themelor në Prishtinë është shpallur jo kompetente dhe pas pranimit ku u është refuzuar prapësimi ata janë ankuar në Apel, ku Gjykata e Apelit ka pranuar Ankesën e tyre dhe lenden e ka kthyer në ri procedim presim vendim e Gj. Themelore në Ferizaj. Po ashtu gjatë këtyre muajve, **KRM "Pastërtia"**, ka ushtruar një Propozim për Përmbarrim ndaj nesh, për gjoja detyrimet që u kemi ne atyre në vlerë 218,013.13 Euro. Ne, e kemi kundërshtuar këtë Propozim me Prapësim, ngase nuk kanë asnjë baze ligjore me të cilën e faktojnë këtë obligim. Lënda ka shkuar në Gjykate dhe Gjykata fatkeqësisht ka refuzuar prapësimin tone dhe ne jemi ankuar në Gj. Apelit, megjithatë është rast që rrezikojmë ta humbim. **KRM "Pastërtia"**, ka ushtruar një padi për kompensim demi lidhur me caktimin e tarifës për mbetjet shtazore, ne kemi dhënë përgjigjen në padi dhe presim ftesën e Gjykatës Themelore për seance.

Me KRM "**Ekoregjioni**" Prizren dhe "**Eco-Higjiëna**", Gjilan patëm arrite ujdë gjyqësore për shlyerjen e borxheve, por ata nuk u janë përmbajtur ujdëve dhe ne kemi kërkuar nga gjykata ekzekutimin e borxhit përmes propozimit për përmbarrim duke kërkuar ekzekutimin përmes bllokimit të llogarive bankare. Por pas bllokimi të xhirollogarive kemi arritur marrëveshje dhe deri me tani jemi duke u përmbajtur marrëveshjeve.

Sa i përket një klienti privat **SH.P.K "IS-Company"** dhe Gjykata ka lëshuar aktvendim për lejimin e propozimit për Përmbarrim, klienti ka bere një shume të pagesës dhe kemi një marrëveshje, në rast se nuk i përmbahet ua bllokojmë xhirollogaritë. Po ashtu përmes Përmbarruesit Privat, kemi ushtruar propozime për Përmbarrim për Klientët tanë **GARKKO Sh.P.K** për vlerën 18.872 Euro dhe **Prestige Media** për vlerën 10,334 Euro, të cilët na detyrohen në baze të kontratave dhe shërbimeve që u kemi ofruar. GARKKO-se i janë bllokuar llogarite por nuk ka mjete dhe Përmbarruesi Privat do ja regjistroje astet që

shumen e borxhit. Po ashtu gjate këtij tremujori kemi iniciuar edhe një procedure përmbartimore për ish-klientin **SRI Kosova SH.P.K.** Pas urdhrit për përmbartim, kanë ushtruar prapësim dhe lënda ka kaluar në Gjykate, ku Gjykata Themelore ja ka refuzuar prapësimin, ata janë ankuar dhe lënda është në Gj. Apelit. Në vitin 2014, një ish-Kontraktor i KMDK-se **TALI SH.P.K, Gjilan**, kishte ushtruar Propozim për Përmbartim për një shume 5,640.09 Euro, por ne patëm bere Prapësim dhe Gjykata e ka Aprovuar Prapësimin tonë, ata janë ankuar në Gj. Apelit.

Gjate këtij viti kemi **ushtruar edhe dy Ankesa pranë Departamentit Administrativ-Divizioni Fiskal i Gjykatës Themelore në Prishtinë**, ndaj vendimeve të Departamentit të Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës për refuzimin e ankesave tona për kompensimin e debi-kredive.

Rasti i Rrahime Krasniqi, lidhur me aksidentin qe ka ndodhur në DS Gjilan në vitin 2010, siç edhe jeni të njoftuar ky kontest ka të beje me kompensimin e demit material dhe jo material, me kërkesën e palëve është vendosur të behën dy ekspertiza, pas përfundimit të raporteve kemi mbajtur seancën e fundit dhe kemi kundërshtuar raportet mjekësore dhe padinë. Megjithatë me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan ne jemi dënuar në vlerë prej 11,500 Euro. Kundër këtij Aktgjykim kemi ushtruar ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë. Gjykata e Apelit ka aprovuar Ankesën tone dhe lenden e ka kthyer në rigjykim në Gjykatën Themelore në Gjilan. Kemi mbajtur disa seanca dhe gjate muajit Mars 2017 kemi arritur ujdj gjyqësorë ku i kemi paguar paditëses 3200 Euro në emër të kompensimit të demit, kurse 850 Euro shpenzime të procedurës gjyqësorë.

Rasti i një kontesti të një ish-punëtori të KMDK SH.A, i cili na ka paditur për konflikt administrativ, ndaj këtyre ankesave dhe aktvendimeve të Gjykatës Supreme kemi ushtruar përgjigje në padi dhe ankesa. Po ashtu për këtë rast Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka mare një aktvendim ku shpallet Jo kompetent në pikëpamje lëndore dhe lënda ti dërgohet Departamentit të Përgjithshme. Pala ka ankimuar këtë aktvendim, Gjykata ja ka refuzuar dhe lenden ja ka dërguar Departamentit të Përgjithshëm të Gjykatës Themelore në Prishtinë, në Nëntor kemi mbajtur seance dhe është kërkuar që të behet ekspertize financiare, presim Aktvendimin dhe ftesën e Gjykatës. Në rastin e kontestit të punës me ish-kryepunëtorin e DS-Mirash, Gjykata ja ka refuzuar padinë dhe kërkesëpadinë, i njëjti është ankuar dhe lënda gjendet në Gjykatën e Apelit. Po ashtu kontest të punës kemi edhe me ish-Kryshefin z. A. Ramadani, ku kemi mbajtur seance dhe kemi ofruar provat tona kemi seancën e radhës, ku janë ftuar si dëshmitar edhe disa prej anëtareve të ish-BD, pas kësaj kemi pranuar Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, ku ka aprovuar kërkesëpadinë e z. Ramadani, për të ja paguar gjitha pagat dhe shpenzimet tjera qe nga largimi si dhe kthimin në vendin e punës. Ne, kemi ushtruar Ankese dhe lënda gjendet në Gjykatën e Apelit. Po ashtu kemi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore për një ish-punëtor i yni ish Teknik i Makinerisë, ku Gjykata na obligon që ta kthejmë në pune me të drejtat dhe obligimet qe ka pasur dhe kompensimin e pagave nga momenti i largimit. Ne kemi ushtruar Ankese në Gjykatën e Apelit kundër këtij Aktgjykimi. Po ashtu patëm pranuar edhe një padi nga një punëtor i KEK-ut për kompensim demi se gjoja është lënduar nga qentë endacak qe rrinë në DS-Mirash, por gjate seancave paditësi ka hequr padinë ndaj nesh. Po ashtu kemi pranuar edhe një padi nga ish-Përgjegjësi i Deponise në DS-Gjilan dhe kemi mbajtur një seance, Gjykata në Gjilan u shpalle jo kompetente dhe ata janë ankuar në Gj. Apelit, ku i është refuzuar ankesa dhe lenden e tij do ta shqyrtoje Gjykata Themelore në Prishtinë. Po ashtu kemi pranuar një padi nga një ish punëtor i ynë ish-voztës i Makinerisë në DS-Mirash Hashim Dragusha, pasi nuk është vazhduar kontrata, këtë TM kemi pranuar Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, ku z. Dragushes i është refuzuar padia dhe kërkesëpadia. Po ashtu kemi pranuar Ankesën e z. Dragusha kundër këtij Aktgjykimi për Gjykatën e Apelit.

o-Përmbledhja e procedurave gjyqësore për 2018

Në rast se ndonjëri nga klientët tanë apo edhe kontraktoret nuk u përmbahen obligimeve ndaj neve bazuar në kontratat qe kemi, mund të kërkojmë qe këto obligime të realizohen përmes përmbartueseve privat dhe procedurave gjyqësore. Po ashtu gjate vitit 2018 do vazhdojnë disa konteste të punës qe paraqesin rrezik për realizimin e Planit të Biznesit 2018.

p-Transaksionet e Konsiderueshme që përfshin NP

Nr.	Emërtimi i klientit/Operatorit	Vendi	Statusi
1.	KRM" PASTRIMI" SH.A	Prishtinë	Klient
2.	Balkan Petrol	Prishtinë	Operator Ekonomik
3.	KRM "Eco-Regjioni" SH.A	Prizren	Klient
4.	HIB Petrol SH.P.K	Ferizaj	Operator Ekonomik
5.	Allmakes Global Servisis "AGS"	Fushë Kosovë	Operator Ekonomik
6.	"Eco-Higjiena" SHPK	Gjilan	Klient
7.	KRM"PASTERTIA" SH.A	Ferizaj	Klient
8.	KRM Cabrati	Gjakove	Klient
9.	Eklogjia	Ferizaj	Operator Ekonomik
10.	Euro-Via	Prizren	Operator Ekonomik

Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë KMDK SH.A ka xhirollogarinë kryesore në: Procredit Bankë me numër 1110-2060-89-0001-81

Xhirollogarinë për donacione me numër 1110-2060-89-0001-71

Xhirollogarinë për subvencion me numër 1110-206089-0001-20

q-Sugjerime dhe propozime për ndryshime të cilat me arsye pritët që ta rrisin performancën e NP

KMDK SH.A ka qenë mjaft aktive si në operative, financa, etj. Normalisht që aktivitetet duhen intensifikuar edhe me tutje në gjithë nivelet, me synim arritjen edhe me tutje të rezultateve. Niveli i duhur profesional për punët e operativës neper deponi, duke filluar nga monitorimi online i sasive të sjella të mbeturinave në hyrje të Urave matëse elektronike dhe në veçanti ato të Mirëmbajtjes së planifikuar të Makinerisë së Rendë, është mese e domosdoshëm, marrë parasysh numrin e defekteve dhe mirëmbajtjen jo gjithë here të duhur, të cilat kanë ndikuar dhe tani ndikojnë drejtpërdrejt në efikasitetin e menaxhimit të mbeturinave neper deponi dhe në koston e operatives.

Gjatë vitit 2017, do duhej që Aktivitetet për Aplikim të Partneritetit Publiko-Privat të jenë me intensive, marre parasysh mundësinë e trajtimit dhe të riciklimit të mbeturinave. E gjithë kjo do mund të realizohet ne bashkëpunim me Sektorin privat, duke vendosur Qendra të riciklimit të mbeturinave në Deponite e Mirashit, Gjilanit, Podujevës, Prizrenit dhe në Stac. e Transferit.

3. Raporti i Zyrtarit Kryesor Ekzekutiv

3.1. HYRJE

RAPORTI I KE PËR VITIN 2017

Gjatë vitit 2017 përkundër sfidave që jemi përballur, disa prej tyre janë përcjell prej një viti në vitin tjetër, po thuaja se nga bartja e kompetencave nga AKM tek institucionet Shtetërore, siç është inkasimi dhe rasti i Deponisë Sanitare (DS) në Mirash. Kompania për Menaxhimin e Deponive të Kosovës (KMDK SH.A), është duke u konsoliduar dhe stabilizuar si në aspektin financiar ashtu edhe në atë operativë.

Ky stabilizimi është bërë duke zbatuar Planin e Biznesit (PB), duke respektuar ligjet dhe obligimet që dalin nga to, sidomos në trajtimin e mbeturinave në DS dhe Stacion të transferim (ST), duke ofruar shërbime sa më të mira për klient, me qëllim të ruajtjes së mjedisit.

Përkundër të gjitha sfidave, kur të kemi parasysh tarifën tejet të ulët 5.31eur/t për trajtimin e mbeturinave, mirëpo falë angazhimit të makromenaxhmentit (role të veçantë ka pas Bordi i Drejtorëve), dhe të gjithë punonjësve të kompanisë kemi arritur që në vitin 2017 ti realizojmë objektivat e parapara me PB. Duhet theksua se përmbushja e PB dhe ngritja e performances së kompanisë, sidomos të projekteve investuese është bërë nga të hyrat vetanake, pa pasur mbështetje nga institucionet qeveritare.

Qëllimi kryesor dhe të përhershëm i KMDK-s është që përmes aktiviteteve të saj të përmbushë misionin që ka kompania, për ruajtjen e mjedisit, në vazhdimësi kemi krijuar kushte më të mira për klientët të cilët sjellin mbeturina, kemi bërë shtrirjen, kompaktimin dhe mbulimin e mbeturinave, kemi mbajtur nën kontroll ujërat e zeza.

Falë angazhimit të përbashkët, kemi arritur të arkëtojmë një pjesë të borxheve dhe të realizojmë inkasim në bazë të asaj që është faturuar, duhet theksuar se i jemi mirënjohës aksionarit për mbështetje, meqë rast ja kemi arritur që për herë të parë ta përmbyllim vitin pa humbje. Këtë e dëshmojmë me a parametra matës: Në vitin 2017 kemi arritur një inkasim prej 116.8% krahasuar me faturimin, ndërsa në vitin 2016 ka qenë 118%; faturimi në vitin 2017 krahasuar me vitin paraprak ka qen për 99.91% apo ma i vogël për 0.09%, ndërsa plani i biznesit nga Faturimet është realizuar në 97.91%, po ashtu edhe inkasimi i planifikuar për vitin 2017 ka arrite përmbushjen prej 85.94% në këtë mos përmbushje ka ndikuar mos definimi dhe tej zgjatja e kontesteve Gjyqësore dhe Përmbartimorë, për informim në kohën kur unë e kam marr detyrën në fund të vitit 2011, inkasimi ka qenë 62%.

Nëse kthehemi në retrospektive dhe analizojmë angazhimin tonë kompania për çdo vit ka bërë progres dhe ka shkuar drejt stabilizimit financiar dhe e ke tejkaluar situatën e kolapsit para falimentimit të viteve të me hershme sidomos të kohës kur unë e kam marr detyrën më menaxhuar KMDK-ne.

Duhet theksuar se si në vitet e fundit, as këtë vit nuk jemi përballur me situata të shfaqjes së zjarreve, ujërat e zeza kanë qenë nën kontroll, megjithatë, këtu duhet veçuar problemin e ujërave të zeza në Deponinë Sanitare në Regionin e Prishtinës (Mirash), problem i krijuar që nga viti 2008. Rreth problemit të ujërave të zeza të DS në Mirash është i informuar aksionari rregullisht në raportet tona mujore dhe vjetore.

Për gjendjen e rëndë të kësaj deponi, e vërteton raportin GIZ-it i vitit 2017, ku janë bërë “Analizat kimike të ujërave të kulluara të deponisë së mbeturinave dhe ujërave nëntokësor”.

Duke u bazuar në raportin e IFC-s të vitit 210 dhe të GIZ-it i vitit 2016 dhe rekomandimeve të dala në nga këto raporte, KMDK SH.A. ju ka dërguar shkresë Ministrive përkatëse dhe Qeverisë, me propozim që kjo deponi të mbyllet përkohësisht deri në rehabilitimin e saj, për shkak të rreziqeve që mund të ndodhin nëse vazhdohet të pranohen mbeturinat, fatkeqësisht deri më sot nuk kemi gjetur mbështetje. Kemi bërë

arsye të rrezikut permanent që mundë të shkaktohen në mjedis.

Në aktivitetet operative, pengesa kryesore është tarifa tejet e ultë për trajtimin e mbeturinave, e cila me vite të tëra nuk ka ndryshuar dhe as për afërsisht nuk e mbulon koston e operimit, pengesë tjetër janë makineritë, e trashëguar në gjendje plotësisht të amortizuara. Këto pengesa e dhe mos mbështetja nga Aksionari të projekteve tona, e pamundësojnë kompaninë për të filluar me ndonjë projekt zhvillimor, por edhe të jetë e pagatitur për detyrimet që dalin pas përfundimit të jetëgjatësisë së deponive sanitare.

Përkundër vështirësive të cekura KMDK SH.A i ka përmbushur caqet e përcaktuara në Planin e Biznesit. Ketë vit kemi realizuar projekte si, blerja e një buldozeri, një makineri për teknikat-mekaniket, është realizuar projekti për dezinfektim, deratizimi dhe dezinfektimi i deponive në vazhdimësi kemi investuar në mirëmbajtjen e infrastrukturës, kemi investuar në projektin e vendosjen e sistemit të gypave për gazifikim (lirim të gazit), në rrjetin elektrik në DS e Gjilanit, trajtimin e ujërave të zeza, riinstalimi i sistemit të drenazheve të ujërave atmosferike, e gjithë kjo për të krijuar kushte sa më të mira për klientë tanë, ndërsa qëllimi kryesorë i këtyre projekteve është ruajtja e mjedisit.

Përkundër të gjitha vështirësive të cekura më lart, në përgjithësi viti 2017 ishte ndër vitet më i suksesshëm si në aspektin administrativë, operativë dhe financiar.

Në Departamentin e Administratës, janë përgatitur shumë vendime me interes të kompanisë, janë protokolluar, arkivuar dhe failuar të gjitha dokumentet hyrëse dhe dalëse që nga themelimi i kompanisë. Ky departament gjithashtu ka përgatit dhe përpiluar listat e pagave, shujtave, të të gjithë punonjësve të kompanisë. Gjatë këtij viti administrata ka shpallur konkurse sipas Planit të Biznesit, ka organizuar intervista dhe ka përpiluar kontrata e aneks kontrata të ndryshme.

Në fushën e prokurimit publik është punuar sipas planit të prokurimit dhe janë respektuar të gjitha rregullat e legjisllacionit në fuqi, ku për herë të parë këtë vit është aplikuar E-Prokurimi.

Këtë vit kemi përgatit dokumentet të rëndësishme për kompaninë, siç është Rishikimi i Planit të Biznesit dhe në veçanti Plotësim Ndryshimi i Rregulloreve të Brendshme dhe Rregulloreve të Reja

Gjate vitit 2017 janë protokolluar 994 dokumente prej tyre 101 vendime të KE-s dhe 13 të BtD të KMDK SH.A.

Në aspektin financiar, janë ndërmarrë disa veprime me qëllim të përmirësuar gjendjen financiare ku të gjitha veprimet janë bërë duke respektuar Standardet e Kontabilitetit. Sektori i financave ka qenë një prej sektorëve më të angazhuar në kompani, duke i përmirësuar disa të meta nga vitet e më hershme, si të llogarive të arketueshme dhe pagueshme, provizionimit të borxheve të këqija, vlerësimit të pasurive të patundshme. Në vazhdimësi është marr me inkasimin e mjeteve, mbikëqyrjen e shpenzimeve, kryerjen e obligimeve ndaj OE, mbikëqyrjen dhe pranimin e faturave.

Të dhënat financiare do të gjeni tek tabelat e performances financiare, operative dhe tek tabelat e pasqyrave financiare.

Në Departamentin e Operatives, janë ndërmarr shumë aktivitete në ngritjen e performancës operative në të gjitha deponit sanitare. I gjithë aktiviteti i operativë është fokusuar në trajtimin e mbeturinave, peshimit, sistemit, kompaktimit dhe mbulimit të mbeturinave e gjithë krodhe mbajtja në kontroll të ujërave të zeza, me të vetmin qëllim për ruajtjen e mjedisit dhe krijimin e kushteve sa më të mira për klientët tonë për deponimin e mbeturinave komunale.

Progresi është arritur duke respektuar dhe zbatuar ligjet që e rregullojnë këtë sektor, sidomos: Ligjin Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Ligjin mbi Shoqëritë Tregtare Nr. 02/L-123, Ligjin për Mbeturinën, Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike, Ligjin mbi Prokurim Publik, Ligjin e Punës dhe ligje tjera, akte nënligjorë dhe rregulloret e brendshme të kompanisë.

3.2. Ngjarjet kryesore të vitit

Aktivitetet gjatë vitit 2017 janë bërë sipas objektivave të parapara në Planin e Biznesit i cili është miratuar nga Bordi i Drejtorëve të KMDK SH.A. Me tërë potencialin intelektual dhe fizik, i gjithë stafi i kompanisë është angazhuar në përmbushjen e objektivave operative dhe financiare.

operativës, në përfundimin e projekteve të parapara me planin e biznesit, me qëllim të ngritjes së cilësisë së shërbimeve tona ndaj klientëve në interes të qytetarëve, sidomos në mbrojtjen e mjedisit.

Ngjarjet që duhet veçuar këtë vit janë:

Në bazë të përgjegjësisë ligjore që kemi në menaxhimin e mbeturinave të amvisërisë (komunale) edhe aktivitetet tona kanë qanë të fokusuar në trajtimin e mbeturinave në DS. Kemi investuar në vendosjen e gypave për lirim të gazit, kemi vazhduar me përforcimin dhe zgjerimin e digës (barrierës) në DS në Mirash, me qëllim që të evitohet fundosjen e deponisë në gropën e krijuar vite më parë që i ngjanë një liqeni.

Ngjarjen tjetër që duhet veçuar për çdo vit është investimi në infrastrukturën e deponive sanitare në sistemimin, shtrirjen, kompaktimin, mbulimin e mbeturinave, mbajtja nën kontroll ujërat e zeza dhe marrja e veprimeve në parandalimin e shfaqjes së zjarreve.

Një projekt tjetër që duhet realizua për çdo vit është projekti për dezinfektimin, dezinfektimin dhe deratizimin (DDD) e të gjitha deponite sanitare i cili është realizuar edhe këtë vit;

Këtë vit kemi vazhduar me hapjen e kanaleve në gjithë e DS, me qëllim që të parandalohen futja e ujërave atmosferik brenda trupit të DS-e.

Në DS në Landovicë kemi realizuar projektin e ngritjes së digës (barrierës) mbi laguna me qëllim që të evitohet rrezikun e shembjes së mbeturinave, të cilat do rrezikonin përmbysjen e lagunave në këtë deponi;

Gjatë këtij viti po ashtu kemi marrë me trajtimin e mbetjeve shtazore (eshtrave), të cilat jem duke i pranuar sipas vendimit të nxjerr nga MMPH.

Duhet theksuar se këtë vit nga mjetet vetanake kemi investuar në blerjen e një buldozeri i cili ka lehtësuar shumë punën tonë kur dihet se shumicën e makinerisë e kemi tërësisht të amortizuar.

Gjithashtu këtë vit nga të hyrat vetanake kemi furnizuar me disa kontejner për bartje të mbeturinave.

Kemi zhvilluar disa takime me përfaqësuesit e KRM-ve, Komunave, Doganës, GIZ, Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Ministrisë së Financave dhe shumë investitor të interesuar me investuar në sektorin e mbeturinave.

Jemi duke i vazhduar kontaktet me MZHE dhe me përfaqësues të GIZ-it, për të realizuar disa projekte, në veçanti projektin për rehabilitimin e DS në Mirash por edhe në deponit tjera me financim të KFW-s. Gjatë këtij viti kemi realizuar disa vizita në vende të ndryshme, për të parë nga afër trajtimin e mbeturinave komunale përmes të formave të ndryshme të riciklimit, me këtë rast duhet veçuar vizitën në Elbasan ku ishte ndërtuar Impianti për prodhim të energjisë përmes procesit të djegies së mbeturinave.

3.3. Pasqyre të performancës operative dhe rezultatet e indikatorëve kyç të performancës

Gjatë vitit 2017 aktivitet kryesorë janë zhvilluar në ngritjen e performancës së kompanisë si në aspektin financiar, sidomos në Deponite Sanitare Regjionale dhe Stacion e Transferit, në administrimin e mbeturinave, në peshimin, sistemimin, kompaktimin, si dhe mbulimi po thuaj të tërësisht të mbeturinave në të gjitha deponite sanitare.

Progresi i arritur është bërë falë angazhimit të të gjithë punonjësve, stafit menaxherial bashkërisht me Bordin e Drejtorëve të KMDK SH.A, ky progres mund të vërehet nga indikatorët e paraqitur si më poshtë:

- **Rritja e inkasimit dhe faturimit,**
- **Avancimi i sistemit të operimit të deponive sanitare regjionale,**
- **Përfundimi i projekteve të parapara sipas planit të biznesit,**
- **Ngritja e vlerës së asetëve të kompanisë,**
- **Përforcimi i kontrole,**
- **Uljen e shpenzimeve,**

Indikatorët kryesor për vlerësimin e performances së kompanisë sipas planifikimit janë:

- **Shkalla e faturimit 97.91%**
- **Shkalla e Inkasimit ndaj faturimit 116.8%**
- **Ulje të shpenzimet totale 10.33 %.**
- **Norma e mbulimit me punë 1.30**
- **Norma e Punës, 1.11**

Efekt të drejtpërdrejt në nivelin e inkasimit ka pasur rritja e faturimit, gjithashtu kjo ka ndikuar në efektet e norme e mbulimit të punës, normën e punës dhe ulje të lehet të shpenzimeve. Këto komponentë kanë ndikuar në ngritjen e nivelit të cilësisë së shërbimeve dhe ruajtjen e kredibilitetit të kompanisë dhe rritjen e performances.;

Avancimi i sistemit të operimit- me blerjen e makinerisë buldozer, me riaftësimin-riparimin e makinerisë së rëndë në Deponit Sanitare Regjionale, është bërë avancim i dukshëm në administrimin e mbeturinave, është ngrit dukshëm cilësia e punëve dhe shërbimeve, në ruajtjen e mjedisit i cili është edhe misioni i kompanisë;

Përfundimi i projekteve të parapara sipas planit të biznesit - Kemi arritur progres në të vazhdueshëm në përmirësimin e gjendjes infrastrukture, në bazë të planit të biznesit dhe atij operativë, janë hapur sektor të rinj për pranimin e mbeturinave dhe janë vendosur gypat për lirim të gazit. Kemi realizuar Projektin e i Dezinfektimi, Dezinfektimit dhe Deratizimit në të gjitha DS dhe ST. Këtë vit kemi realizuar projektin e ngritjes së barrierës (murit) mbrojtës në pjesën sipër lagunave në DS në Landovicë me qëllim të parandalimit të shembjes së mbeturinave, meqë rast është evituar të ndodhë ndonjë pasoja paparashikuar mjedisore ujërat e të zeza në atë regjion.

Ngritja e vlerës së asetëve të kompanisë- Me trajtimin e mbeturinave, peshimin , shtresimin kompaktimin dhe mbulimin, vendosjen e gypave të lirimit të gazit në asnjërën prej deponive sanitare nuk kemi shfaqje të zjarreve, rrjedhje të ujërave të zeza (përjashtuar rastin e Mirashin). Me aktivitetet dhe investimet në infrastrukturë, me funksionalizimin e makinerisë së rëndë, me blerjen e një makineri të re buldozer dhe investimeve tjera, kompanisë i është rritë vlera e tregut, është tejkaluar situata e rëndë e cila ka qenë para falimentimi. Tani është në rrugët mirë të stabilizimit financiar – operative dhe është duke u përgatitur për të kaluar në fazat zhvillimor.

Përforcimin e kontrolles- Gjatë këtij viti kompania ka nxjerr një sere rregulloresh të reja dhe i ka bërë ndryshim plotësimin e atyre ekzistuese, e gjithë kjo për të qartësuar përgjegjësit, për të dhënë përgjegjësi të reja me qëllim që të ketë një mbikëqyrje dhe kontroll administrative, financiare e sidomos operative. Janë nxjerr dhe miratuar shume vendime e urdhëresa administrative për të pasur një kontrolle sa më efikase të brendshme të kompanisë.

Bashkëpunimi me palët e interesit- është bërë duke respektuar statusin e kompanisë, duke respektuar ligjet në fuqi, rregulloret e brendshme ligjore, me qëllim të përmbushjes së obligimeve, që të kemi menaxhim më të mirë t financave dhe të operativës.

Kemi bashkëpunuar me **Institucionet shtetërore të dy niveleve**, (qendror dhe lokal).

Nga **niveli qendror**, (Ministrit: MZHE,MMPH,MF, MBZHR, AVUK, Agjencinë Mjedisor, Inspektoratin Qendror dhe Lokal, AVUK, Doganat e Kosovës) e tjerë. Nga **niveli lokal**, (Kryetar Komunash, Nënkryetar Komunash, Drejtor të Drejtoreve, Inspektor, duhet veçuar bashkëpunimin me **Kompanitë Regjionale të Mbeturinave (KRM)**.

Në këtë vit jemi takuar edhe me Komisionin Qeveritar për falje të borxheve, KMDK ka respektuar dhe e ka zbatuar Ligjin për Falje të Borxheve, sipas Ligjit për Faljen e Borxheve ka përfshirë prridhen para e deri me 31/12/2008. Gjatë këtij viti kemi bashkëpunuar dhe kemi qenë të hapur për të gjitha mediat e interesuar elektronike dhe të shkruara, përfaqësues të shoqërisë civile etj.

Kontaktimi i institucioneve financiare ndërkombëtare - me qëllim të përfitimit të mbështetjes së projekteve të KMDK-ës kemi zhvilluar takime dhe ke kemi shkëmbyer informacione me institucione financiare ndërkombëtare, duhet veçuar bashkëpunimin me GIZ- Gjerman.

3.2. Gjendja e Deponive Sanitare të KMDK SH.A

Në vitin 2017 fokusimi kryesor i aktiviteteve të kompanisë kanë qenë, në peshimin, evidentimin e zbrazjeve në hyrje dhe dalje në sektorin e mbeturinave, rrafshimin, kompaktimin dhe mbulimin e vazhdueshëm të mbeturinave. Pastaj është bërë hapja e sektorëve të ri për zbrazje, mirëmbajtja, ndërtimi i rrugëve brenda sektorëve, ri qarkullimi i ujërave të zeza në trupin e deponisë dhe mbajtja nën kontroll e ujërave të zeza dhe të atyre atmosferike.

Gjendja në DS-Mirash -Obiliq

Në DS Mirash aktivitetet kryesore gjatë tërë vitit janë zhvilluar në përmbushja e planit operativ të punës në raport me planin vjetor të punës dhe rekomandimet tjera të punës. Gjendjen në sektorin e pranimit të mbeturinave gjatë tërë vitit e kemi pasur të mirë, me mundësi të kapaciteteve të mjaftueshme për pranim të mbeturinave gjatë gjithë vitit. Infrastruktura përcjellëse për çdo sektor është mirë e rregulluar dhe funksionale, duke përfshirë rrugën nga hyrja në peshore e deri në sektorët e zbrazjes.

Kujdes i veçantë i është kushtuar mbulimit të mbeturinave me shtresën e dheut, aktivitet ky i realizuar gjatë tërë vitit, si procese mjaft i rëndësishëm me qëllim të parandalimit të kundërmimit dhe shfaqjes së zjarreve. Kohë pas kohe kemi investua-punuar në ngritjen e mureve mbrojtëse për rreth deponise, me qëllim të evitimit të rrezikut nga ujërat e zeza të pakontrolluara në liqenin akumulues. Krahas ngritjes me mbeturina, në sektorët gjithëpërfshirës kemi ngritur edhe gypat për lirim të gazit, kemi bere zhvendosjen e disa prej objekteve, më qellim të lirim të hapësirës për mbeturina dhe kemi rivendosur të njëjtat objekte në një hapësirë tjetër duke i përshtatur me kërkesat dhe nevojat e deponise.

Një aktivitet tjetër mjaft i rëndësishëm është bërë në zhvendosjen e mbulesës nga konstruksioni metali së bashku me rezervuarin e derivateve të naftës , gjithashtu është zhvendosur trafo stacioni nga lokacioni i vjetër në lokacion të ri , është bërë ri -instalimi i kablllove elektrike , zhvendosja e automjeteve defekte, demolomi i objektit si dhe lirim të hapësirës për krijimin e sektorit të ri për zbrazje gjatë gjithë vitit.

Me qellim të mbrojtjes mjedisit, punëtorëve të cilët punojnë në këtë DS , klientëve tonë, është përfunduar projektit të D.D.D. nën mbikëqyrje të zyrtares për mbrojtje të mjedisit

Aktivite tjera:

Gjendja e ujërave të zeza është alarmantë ashtu siç është raportuar edhe viteve paraprake, nuk ka pasur aktivitet për trajtimin e tyre , përkundër shkresave dhe projekteve të cilat i kemi dërguar tek Aksionari.

Gjendja e makinerisë: Gjatë këtij viti përkundër disa defekteve dhe riparimeve që i kanë bërë tekniket e kompanisë por edhe me angazhimin e OE gjendja e makinerisë është e mirë.

Kompaktori Bomag funksional, Makineria Skip Fermecc jofunksional, në fillim të muajit Qershor OE ka bere furnizimin me një makineria (Buldozer) Liebherr në këtë DS– kjo makineri është funksionale.

DS Velekincë - Gjilan:

Në këtë deponi është përmbushur plani operativ i punës, në raport me planin vjetor të punës dhe me rekomandimet tjera të punës. Gjendja në sektorët e pranimit të mbeturinave është shumë e mirë, me mundemi të pranimit, por me shkallë të rrezikut nga prezenca e personave fizik. Kemi bërë vendosjen dhe

mbeturinave me shtresën e dheut. Niveli i lagunave nën kontroll dhe kemi sanuar qdo rrjedhje të mundshme të ujërave, hapjen e kanaleve kulluese dhe të gjitha ujërat përfundojnë në llaguna.

Për shkak të vazhimit të prezencës së personave fizik privat pa autorizim, ka ndodh edhe një fatkeqësi me fatalitet, ku ka humbur jetën edhe një mbledhës i mbeturinave. Kemi vendosur shenja sinjalizuese dhe paralajmëruese në DS në ato pika ku kohë më parë janë dëmtuar nga personat fizik, për ndalim të personave të pa autorizuar kemi ngrit edhe njëherë shqetësimet dhe kërkesat tona pranë policisë, veçanërisht kërkesën për largim të këtyre personave.

Aktivitete tjera:

Aktivitetet për pranimin e mbeturinave jemi duke i zhvilluar në bazë të planit operativë në një qelizë punuese të planifikuar në zgjerim nga arxhinaturat e dheut. Janë zhvilluar aktivitetet shtesë në mbulimin e mbeturinave me qëllim të parandalimit të tyre nga kundërmimi dhe zjarret duke marrë parasysh temperatura e larta të cilat kanë mbretëruar gjatë muajit qershor. Gjatë këtij viti kemi pasur aktivitete në mirëmbajtjen e zonave gjelbëruara, parqeve, ndërtimin e një pushimore, mbjelljen e luleve për aktivitetet rekreative etj.

Për shkak të vazhimit të prezencës së personave fizik privat pa autorizim dhe pa leje dhe për shkak të neglizhencës së polices, kemi rivendosur shenjat sinjalizuese dhe paralajmëruese në DS në ato pika ku kohë më parë janë dëmtuar nga personat fizik, për ndalim të personave të pa autorizuar i kemi ngrit edhe njëherë shqetësimet dhe kërkesat tona pranë policisë, veçanërisht kërkesën për largim të këtyre personave.

KMDK edhe pse në vazhdimësi ka ngritur shqetësimet dhe ka raportuar për prezencën e personave fizik të paautorizuar brenda trupit të deponis, dëmtimeve që i janë bërë rrethojave nga po këta persona të paautorizuar, rrezikut që paraqesin gjatë kryerjes së obligimeve të përditshme të punës, në veçanti prezenca e tyre pa leje në sektorin e zbrazjes, nuk është mbështetur nga institucionet përgjegjëse për siguri dhe kërkesat tona janë injoruar. E gjithë kjo, për pasoj dhe me fatalitet, njeri nga personat e paautorizuar, nga lëndimet e marra aksidentalisht në sektorin e zbrazjes, ka humbur jetë. Rasti është proceduar në polici.

Personeli: Përfundon detyrat e punës sipas planit operativë në matjen, evidentimin, mirëmbajtjen si dhe sigurinë e Deponisë.

Vërejtje: Prezenca e personave të pa autorizuar ende është aktive, pa leje dhe pa autorizim dhe përkundër rivendosjes së shenjave dhe kërkesave të pandërprera në polici, prezenca e tyre rrezikon kryerjen e punëve operative.

Trajtimi i ujërave të zeza: Ujërat e zeza kanë qenë në monitorim të vazhdueshëm, po ashtu edhe nën kontroll, vazhdimisht janë lëshuar pompat dhe janë ndërruar pozitat e gypave, janë sanuar problemet në rrjetin elektrik, servisuar pompat etj.

Me qëllim të mbrojtjes mjedisit, punëtorëve të cilët punojnë në këtë DS, kemi angazhuar operatorin për kryerjen e Projektit të D.D.D i cili ngjashëm është realizuar edhe në DS tjera nën mbikëqyrje të zyrtares për mbrojtje të mjedisit.

Gjendjen e makinerisë

Makineria Fiat Hitachi – ka qenë funksionale përkundër disa problemeve mekanike Kompaktori Bomag – ka qenë jofunksional për shkak të motorit.

Gjendja në DS Landovicë- Prizren:

Gjate tërë vitit janë zhvilluar aktivitetet për pranimin e mbeturinave në bazë të planit operativë në një qelizë punuese të planifikuar në zgjerim nga arxhinaturat e dheut. Janë zhvilluar aktivitetet shtesë në mbulimin e mbeturinave me qëllim të parandalimit të tyre nga kundërmimi dhe shfaqjes së zjarreve.

të dhëna nga drejtoria e operativës, ky projekt është përfunduar.

Përgjatë këtij viti gjendjen në sektor të pranimit të mbeturinave e kemi pasur të mirë, mundësit për pranim përgjatë këtij sektori janë të mjaftueshme për tërë vitin. Kemi investuar në mirëmbajtjen e rrugëve dhe kohë pas kohe edhe në mbulimin e mbeturinave. Kemi përfunduar projektin për vendosjen e gypave vertikal në gjithë hapësirën e deponise, me qëllim të lirimit të gazit dhe uljes së rrezikut nga shfaqja e zjarrit. Kemi përfunduar projektin për sanimin e rrjedhjes së ujërave në sipërfaqen e poshtme të dy lagunave. Është bërë gërmimi-hapur kanalet, janë gjetur rrjedhjet e ujërave-kryesisht të bardha, janë vendosur gypat dhe kolektorët. Përmes këtij investimi kemi evituar rrezikun e shembjes së dheut që do të rrezikonte lagunat. Po ashtu investimet në ndërtimin e murit mbrojtës mbi laguna është përfunduar dhe ka mbetur vetëm thyerja dhe rrafshimi i skarpatesh-bregores.

Gjendja me ujërat të zeza është në kontroll, kemi arritur për herë të parë të bëjmë tharjen e një liqeni të krijuar nga ujërat atmosferike dhe të zeza, është tharë në tërësi.

Trajtimi i ujërave të zeza: Ujërat e zeza kanë qenë në monitorim të vazhdueshëm, po ashtu edhe nën kontroll, vazhdimisht janë lëshuar pompat janë ndërruar pozita e gypave, janë sanuar problemet në rrjetin elektrike, servisuar pompat etj.

Me qëllim të mbrojtjes mjedisit, kemi angazhuar operatorin për kryerjen e Projektit e D.D.D, projekt i mbikëqyrur prej zyrtares për mbrojtje të mjedisit.

Gjendjen e makinerisë, makineria Dressta në përgjithësi funksionale, Kompaktori Bomag është funksionalizuar, Makineria Fiat Hitachi –është duke u riparuar. Makineria Liu Gong pas disa intervenime është funksional(e cila në muajin Qershor është bartur nga Mirashi në Landovicë).

DS- Podujevë:

Gjatë këtij viti jemi ballafaquar me vështirës operative në shtyrjen e mbeturinave për shkak të mungesës së makinerisë, kemi zhvilluar aktivitete të kufizuara duke marrë parasysh koston operative. Kohë pas kohe për zhblokimin e situatës kemi angazhuar operatorin ekonomik në hapjen e rrugëve, shtyrjen e mbeturinave në mënyrë që krijohet hapësirë e mjaftueshme për pranimin e mbeturinave.

Konform kërkesave të Inspektoreve të MMPH kemi përgatit planin e punës, kemi përfunduar vendosjen e gypave për lirim të gazit, kemi sanuar çdo rrjedhje të mundshme të ujërave të zeza jashtë trupit të deponise përmes vendosjes së gypave dhe kolektorëve të cilët përfundojnë në laguna, pjesërisht kemi bërë mbulimin e mbeturinave me shtresën e dheut.

Trajtimi i ujërave të zeza: Ujërat e zeza kanë qenë në monitorim të vazhdueshëm, po ashtu edhe nën kontroll, vazhdimisht janë lëshuar pompat janë ndërruar pozitat e gypave..

Sikurse në deponite tjera edhe në këtë DS është realizuar projekti i D.D.D i mbikëqyrur nga zyrtarja për mbrojtje të mjedisit.

Stacioni i Transferit-Ferizaj:

Humbjet më të mëdha kompanisë i krijohen nga ky Stacioni Transferit (ST) të mbeturinave, për shkak të punës së dyfishtë që behet me bartje deri në DS pastaj edhe trajtimi i tyre në deponi, ndërsa tarifa e njëjtë ekzistuese nuk i mbulon as për afër kostot e këtij ST. Gjate tërë vitit kemi pasur vështirësi në bartjen e mbeturinave për arsye të disa defekte në kamionët të cilët janë të amortizuar, me skip dhe kontejner të dëmtuar. Për shkak të këtyre vështirësive dhe fluksit të madh të mbeturinave që po vjen është grumbulluar një sasi e konsiderueshme në platon-sektorin grumbullimit. Në tremujorin e tretë jemi furnizuar me disa kontejner të ri për bartjen e mbeturinave.

zeza edhe në ST është realizuar projekti i D.D.D .

Gjendjen e makinerisë në ST Ferizaj Fordi i kuq ka qenë pjesërisht funksional, Iveco e bardhe- pjesërisht funksionale, Iveco e kuqe është funksionale, Kamioni Ford (Fordi i ri) ka qenë funksional, kemi bere vazhdim regjistrimin e këtij kamioni për një vit Rimorkio transportuese funksionale Rimorkio e ivecos se bardhe është funksionalizuar, makineria Komatsu ngarkues kohë pas kohe ka qenë jashtë funksioni, kjo makineri pothuaj se tërësisht është e amortizuar.

Veturat kanë qenë funksionale me përjashtim të veturës Kia Hyndai 01-706-HF, Mitsubishi 01-869-BP dhe Kia 01-637-HC – funksionale, është blerë edhe një makineri për tekniket për punë në teren.

Raporti i Investimeve për Vitin 2017

- Investimet me mjete vetanake në makineri dhe infrastrukturë nëpër Deponitë sanitare regjionale:

1. Investimet në infrastrukturë në Deponitë Sanitare regjionale	109,660
2. Investimet në riparimin në makinerinë e rëndë	70,513
3. Blerja e makinerisë se rend Bolduzer -LIEBHERR për DS	169,280
4. Blerje e automjetit per nevoja të operatives(xhip-kamionet)	22,881
5. Furnizim me kontejnerë për mbeturina	21,296
6. Paisje kompjuterike dhe inventar zyre	500
Totali i Investimeve me mjete vetanake (1 deri 6)	394,130

3.4. Pasqyre të performancës financiare dhe rezultatet

Synimi i kompanisë gjatë këtij viti ka qenë ngritja e performancës financiare, kjo ngritje e performances, na ka mundësuar që të kemi shërbime cilësore në aktivitetet tona. Progresi i arritur financiar, drejtpërdrejtë ka ndikuar që kompania të bëjë trajtim të mirëfilltë të mbeturinave të deponuara, me qëllim të parandalimit të ndotjes dhe ruajtjes së ambientit.

Progresi i arritur financiar do të pasqyrohet si në tabelën më poshtë- në vijim në formë tabelore.

b-Pasqyra e Performancës Operative dhe Financiare në Krahasim me Vitin Paraprak dhe Aktual

Të dhënat e performancës dhe objektivat	2017	2016
Numri i klientëve të rregullt	45	38
Mbeturinat e hedhura ton*	T- 280,332	T- 275,248
Faturimi*	€ 1,557,553	€ 1,559,119
Inkasimi	€ 1,819,443	€ 1,842,914
Të ardhurat jo operative donacion, grande dhe subvencione	€ 577,927	€ 292,296
Shpenzimet në operim	€ 1,334,327	€ 1,272,352
Shpenzimet nga periudhat e mëhershme	€ 52,341	€ 30,890
Shpenzimet e borxhit te keq (Provizionim)	€ 13,276	€ 0
Shpenzimet e Zhvlerësimit (Amortizimit)	€ 595,879	€ 874,208
Llogaritë e arkëtueshme	€ 883,234	€ 2,776,337
Llogaritë e pagueshme	€ 295,968	€ 406,832
Paratë e gatshme dhe paratë ne banke	€ 67,655	€ 55,065
Shkalla e inkasimit (total)	116.8%	118%
Norma e mbulimit me punë	1.30	1.41
Norma e punës	1.11	1.20
Tarifa mesatare	5.31	5.31
Shpenzimet operative për ton	€ 7.12	€ 7.91

Mbeturinat e hedhura ton*

Të mbeturinat e amvisërisë (konsumuese) kemi rritje për 5468 ton ose shprehur në % kemi 102 % rritje në krahasim me vitin 2016, ndërsa të mbeturinat e jo konsumuese kemi rënie për 383 ton ose shprehur në % kemi 76.24% apo rënie për 23.76%.

Faturimi*

Të të hyrat nga faturimi për mbeturinat konsumuese dhe të jo konsumuese reflektohen nga sasi të lartë shënuara të shprehura në vlerë me një rritje prej 10,017.00 euro .

Po ashtu edhe të hyrat tjera (nga pranimet e materialeve demolative, dheu) kemi rënie për 11,414 euro në krahasim me vitin 2016.

Gjatë vitit 2017 KMDK ka pasur realizim të faturimit për 99.90% në krahasim me vitin 2016.

Shpenzimet operative për ton në vitin 2017 janë 7.12 €, në krahasim me vitin 2016 kur shpenzimet operative për ton kanë qene 7.91 €. Vlen të theksohet se sasia e mbeturinave të menaxhuara në vitin 2017 ka qene për 5,088 tonelata me e larte se sa në vitin 2016.

Shpenzimet e zhvlerësimit (amortizimit) janë në vlerë prej 595,879 Euro. Kjo ka ndodhë për shkak të rivlerësimit të jetëgjatësisë të Deponive nga ana e Komisionit të Kompanisë.

Performanca financiare e KMDK-se për vitin 2017, duke i përfshirë shpenzimet e përgjithshme si dhe shpenzimet e Zhvlerësimit (amortizimit), Kompania nga të hyrat akruale dhe mbështetje me Subvencion nga ana e Aksionarit si dhe njohja e të hyrave të shtyra nga Donacionet dhe Grandet, del me një fitim para tatimit në korporatë prej 210,691 €.

Të gjitha këto komponent janë për tu vlerësuar, kur të krahasohen me tarifën ekzistuese prej 5,31 € për ton e cila nuk është ngritur që nga viti 2008 (përfshirë një ngritje të papërfillur prej 0,05 cent në vitin 2012), ndërsa kostoja e operimit për tonë është 7.12 euro. Kjo diferencë në mes të tarifës dhe koston së operimit për tonë, na shkakton humbje, e bënë të pamundshme që të kemi investime zhvillimore në ngritjen e vlerës së asetëve dhe zgjerimit të kompanisë.

Të dhënat krahasuese me caqet e planit të biznesit

Anex 1

Të dhënat e performancës dhe objektivat	Vlerësimi performancës Janar-Dhjetor 2017	Projektimi preformancës Janar-Dhjetor 2017
Numri i klientëve të rregullt	45	40
Mbeturinat e hedhura në Ton	t- 279,103	t- 278,721
Mbeturinat e hedhura nga mbetjet shtazore	t- 1,229	t- 1,820
Faturimi	€ 1,557,553	€ 1,591,008
Inkasimi*	€ 1,819,443	€ 2,117,008
Të ardhurat jo operative grandet dhe subvencionet	€ 577,927	€ 752,506
Shpenzimet në operim	€ 1,334,327	€ 1,487,986
Shpenzimet nga periudhat e mëhershme	€ 52,341	€ 0.00
Shpenzimet e borxhit të keq (provizionimi)	€ 13,276	€ 0.00
Shpenzimet amortizimit	€ 595,879	€ 888,971
Llogaritë e arketueshme	€ 883,234	€ -
Llogaritë e pagueshme	€ 295,968	€ -
Paratë e gatshme dhe paratë në banke	€ 67,655	€ -
Shkalla e inkasimit (total)	116.8%	100%
Norma e mbulimit me punë	1.30	1
Norma e punës	1.11	1
Tarifa mesatare	5.31	€ 5.31
Shpenzimet operative për ton	€ 7.12	€ 5.31

Inkasimi*

Inkasimi i faturuar për vitin 2017 krahasuar me planin është përmbushur 95.08%, ndersa inkasimi i borxheve me ri programim dhe procedura Gjyqësore dhe Përmbartimore është përmbushur vetëm 58.30%, arsye vonesat në vendosjen e organeve kompetente.

Nga treguesit financiar sipas tabelës, shihet që KMDK SH.A ka përmbushur planin e të hyrave për vitin 2017 për 97.91%, ndërsa KMDK-ja ka realizuar inkasimin e faturimit të planifikuar për 95.08 %-apo vetëm për 4.92 % nuk është përmbushur plani për vitin 2017, ndërsa inkasimi i borxheve me ri programim dhe procedura Gjyqësore dhe Përmbartimore është përmbushur vetëm 58.30%, arsye vonesat në vendosjen e organeve kompetente.

Kompania jonë ka planifikuar të ketë Grande nga Buxheti i Kosovës për vitin 2017, mirëpo për shkak të shkurtimit të mjeteve buxhetore nga Qeveria e Kosovës, në këtë vit kemi realizuar vetëm 114,583 Euro për Subvencionim të blerjeve për shpenzime operative. Plani fizik i menaxhimit të mbeturinave në vitin 2017 nuk është realizuar për 208 tonelata, ose e shprehur në %, 0.07% apo plani është përmbushur për 99,93%.

Shpenzimet operative kane qene me të vogla për 10.33 % në krahasim me ato të planifikuara të vitit 2017. Llogarit e arkëtueshme janë paraqit në baze të lejimit të provizionimit të borxheve të këqija të cilat kërkohen me standarde të kontabilitetit. Shpenzimet operative për ton në vitin 2017 janë 7.12 €-në krahasim me shpenzimet e planifikuara për ton në vitin 2016- të cilat kane qene 7.91 €, marr parasysh Tarifën tejet të ulet për deponim të mbeturinave për ton.

3.5. Progresi me planin e biznesit

Në vazhdimësi që nga viti 2012, për çdo vit kemi arritur progres në menaxhimin dhe administrimin e kompanisë, krahasuar me planin e biznesit të secilit vit paraprak. Kemi arritur progres në investimet e bëra në infrastrukturë, në kompaktim, mbulim të mbeturinave, në mirëmbajtje të makinerisë etj. Kjo është bërë me angazhimin e makro dhe mikromenaxhimentit të kompanisë, e në veçanti falë angazhimit të të gjithë punonjësve tjerë të kompanisë.

Me punën sistematike në sektorët e deponimeve është evituar shfaqja e zjarreve dhe janë mbajtur nën kontroll ujërat e zeza në të gjitha deponit sanitare, përjashtuar në deponin e Regjionit të Prishtinës në Mirash ku problemi me ujërat e zeza është ende prezent.

Progresi i arritur këtë vit sipas planit të biznesit mund të vërehet duke i krahasuar parametrat si më poshtë:

Shpenzimet operative për ton të vitit 2017 është **7.12 €**, kjo kosto do të ishte edhe më e lart po qesë deponimi do të bëhej në të gjitha deponit sipas standardeve gjeneralë. Mirëpo mos trajtimi sipas standardeve për deponimin e mbeturinave e pamundëson tarifa e tejet e ultë për deponim prej **5.31€**. Diferenca në mesë të koston së trajtimit të mbeturinave dhe tarifës, kompanisë i shkaktohen humbje prej **1.81€** për çdo ton të mbeturinave të trajtuara jo plotësisht sipas standardeve.

Avancimi i sistemit të operimit të Deponive sanitare regjionale, (rregullimi i infrastrukturës, rregullimi i celulave të zbrazjes duke krijuar kushte me të mira për klient, vendosja e gypave të lirimit të gazit dhe rregullimi i kanaleve të ujërave atmosferike).

Përfundimi i projekteve të parapara sipas planit të biznesit (Investimi në infrastrukturë, pastrimi, në projekti për dezinfektimin, dezinfektimin dhe deratizimin (DDD) e të gjitha deponite sanitare. Kemi vazhduar me hapjen e kanaleve në gjithë e DS, me qëllim që të parandalohen futja e ujërave atmosferik brenda trupit të DS-e. Në DS në Landovicë kemi realizuar projektin e ngritjes së digës (barrierës) mbi laguna me qëllim që të evitohet rrezikun e shembjes së mbeturinave, të cilat do rrezikonin përmbysjen e lagunave në këtë deponi; Gjatë këtij viti po ashtu jemi marrë me trajtimin e mbetjeve shtazore (eshtrave), të cilat jem duke i pranuar sipas vendimit të nxjerr nga MMPH. Duhet theksuar se këtë vit nga mjetet vetanake kemi investuar në blerjen e një buldozer i cili ka lehtësuar shumë punën tonë kur dihet se

furnizuar me disa kontejner për bartje të mbeturinave.

Progresi i arritur krahasuar me planin e biznesit mund të vërehen në pasqyrat financiare të cilat do të i bashkëngjiten këtij raporti.

3.6. Shpenzimet kapitale dhe projektet

Sipas planit të biznesit janë realizuar këto projekte:

- Realizimi i projektit të Dezinfektimit, Dezinsektimit dhe Deratizimit(DDD);
- Vendosja e gypave të mbledhjes dhe lirimimit të gazit;
- Rregullimin e Pompave nëpër DS si dhe aktivizimin e tyre;
- Zbrazjen e Lagunave nga ujërat e zeza ekzistuese;
- Zgjerimi i Lagunës për pranim të ujërave të zeza Landovicë;
- Blerjen e makinerisë së rëndë Buldozer ;
- Rregullimin e kushteve për punëtor;
- Rregullimi i infrastrukturës, si dhe hapja e sektorëve të ri të zbrazjes duke krijuar kushte ma të mira për klient;
- Rregullimi i infrastrukturës se brendshme dhe të jashtme të deponive;
- Blerja e Kontejnerëve për bartje të mbeturinave nga Stacioni i transferim në DS, etj.

3.7. Perspektiva për vitin e ardhshëm

Ndër aktivitete me prioritet do të jetë përmirësimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës, pastaj trajtimi i mbeturinave duke filluar nga sistemimi, kompaktimi dhe mbulimi, mbajtja në kontroll e ujërave të zeza, blerja e makinerisë së rëndë. Përveç krijimit të kushteve për klientët tanë, qëllimi kryesor do të jetë ruajtja e mjedisit.

Synim strategjike operative dhe financiare i kompanisë për vitin 2018-2020 do ta jetë fillimi i Projektit të ndarjes dhe klasifikimit të mbeturinave komunale në deponite të cilat i menaxhojmë. Ky projekt do ti sjellte profit kompanisë, përveç që do të ketë ndikim ekonomik-social, njëkohësisht do të kemi një mjedis më të pastër.

Synim tjetër imediat të cilin synojmë ta realizojmë qoftë nga të hyrat vetanake apo grandët e ndara nga Qeveria për Investimet Kapitale, është Projekti i trajtimit të ujërave të zeza në DS në Prishtinës dhe vendosjen e qëndrueshmërisë në këtë deponi.

Projektet tjera të cilat synojmë ti realizojmë janë: Ngritja e profilit të KMDK si aktor kyç në zhvillimin e sektorit të Deponive sanitare Regjionale në Kosovë; Ngritja e nivelit të shërbimeve sipas standardeve të përcaktuara me kornizën Ligjore; Blerja e makinerisë së rëndë për trajtim të mbeturinave dhe transportim. Këtë vit do të synojmë të vendosim sistemin e menaxhimit të cilësisë, do të trajnojmë stafin , që të jenë sa më të përgatitur për fazat e ardhshme zhvillimore të kompanisë, për të ofruar jo vetëm dokumente cilësor, sidomos për të ofruar shërbime dhe produkte cilësore.

Sikurse në vitet e kaluara edhe në vitin 2017 do të synojmë të rrisim tarifën për tonelate të mbeturinave të deponimit, për të trajtuar mbeturinat e deponuara sipas standardeve, tarifa nuk do të duhej të jetë më e ultë se 20-25 euro për ton.

3.8. Rreziqet e të ardhmes së korporatës

Makineria e trashëguar që nga koha kur kompania u themeluar, jo vetëm që është plotësisht e amortizuar por nuk po është e mundur as me i riparuar. Mos funksionimi i makinerisë rrezikon vetë operimin në deponi, meqë rast do të ketë pasoja të paparashikueshme për mjedisin.

Rreziqet më të mëdha, për mos përmbushje të planit të biznesit për vitin 2017 do të jenë:

- Proceset gjyqësore të cilat po stërgjatën, si padit që KMDK i ka ngritur ndaj OE dhe personave fizik edhe padit që janë ngritur ndaj KMDK-s.

- Mos zhvillimin e shumë aktiviteteve të parapara me mjetë vetanake për shkak të gjendjes të vështirë financiare që ballafaqohet kompania në blerjen e makinerive të rënda (buldozerë rinj);
- Mungesa e sistemit të ajrosjes dhe gazifikimit në DS paraqet një rrezik jashtëzakonisht të madh, për arsye se, materiet plasëse si metani i cili prodhohet gjatë kalbjes së mbeturinave, në kontakt me lagështin mund të vjen të eksplodimi apo ndezja e zjarreve me rrezik eksplodimi;
- Rrezik për asetet e kompanisë, për makinerinë paraqesin brejtësit (minjtë), të cilët janë shumë me numër shumë të madhe, të cilit dëmtojnë kabllo e makinerisë e cila operon nëpër DS, prezenca e gjarpërinjve, nga këto rreziqe më së shumti mund të atakohen personeli punues.
- Rrezik tjetër për biznesin e kompanisë është tarifën ekzistuese prej 5.31 euro. e vendosura që nga koha kur ZRRUM ishte kompetent për caktim të tarifës.

Vërejtje:

Rreziku më i madh është mos pasja mundësisë e **trajtimit të ujërave të zeza në deponine sanitare në Mirash-Prishtinë**. Për këtë problem IFC që në vitin 2010 ka përgatit një raportit bashkë me rekomandimet dhe veprimet që duhet ndërmar. Gjithashtu unë që nga marrja e detyrës kam ngrit shqetësimet e mia dhe kam raportuar tek BtD dhe në MZHE.

Duke parë se kompania nuk ka mundësi që me mjetë vetanake të evitohet problemi e ujërave të zeza në Mirash, në vazhdimësi kemi kërkuar nga MZHE të mbështesë këtë projekt përmes grave qeveritare, por fatkeqësisht mbështetja që është bërë për këtë qëllim ka qenë mos të themi mospërfillëse, por kanë qenë minimale, ato mjetë janë investuar për të evituar rritjen e rreziqeve tjera.

Që Deponia e Mirashit është një problem me rreziqe të mëdha për ambientin dhe në përgjithësi për mjedisin, ka dëshmuar edhe studimi i bërë nga GIZ-i gjerman për gjendjen e ujërave në DS e Mirashit.

P.S:

- **Mos pasja e mundësisë së investimeve, për ti eliminuar rreziqet në deponi, janë si pasojë siç e theksuam e tarifa ekzistuese prej 5.31 Euro, e cila as për afër nuk e mbulon koston e operimit. Kjo e pamundëson qëndrueshmërinë financiare të KMDK-se, nuk kemi mundësi për të bërë investime në eliminimin e rreziqeve të cekura më lart.**
- **Mos caktimi i tarifës reale prej 20-25 Euro, sidomos kur tarifa prej 5,31 Euro nuk e mbulon koston e operimit, Aksionari (MZHE-Qeveria) e ka për obligim që diferencën e koston të ja mbuloj KMDK-se për mes subvencionimit, këtë çështje e përcakton qarte nenin 13.15, nenin pika (b) e Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.**
- **Ju përkujtojmë në kohën sa KMDK SH.A (ish KLMC) ka qenë nën menaxhimin e AKM-s tarifa ka qenë 8.60 Euro. KMDK SH.A disa herë i ka bërë kërkesë në MZHE, kemi ripërsëritur kërkesën për ngritje të tarifës, mos ngritja e tarifës është pengese për vetë qëndrueshmërinë financiare dhe zhvillimore. Fatkeqësisht asnjëherë deri më sot, të paktën nuk kemi pranuar një shkresë sqaruese se është marr në konsideratë apo është shqyrtuar kërkesa e KMDK SH.A.**

Nga e gjithë kjo që cekem KMDK SH.A nuk do të mbanë përgjegjësi nëse do të përballët me ndonjërin prej rreziqeve të lart cekura.

Në përmbyllje të këtij raporti ju shprehim mirënjohje të gjithëve, për angazhimin, kontributin, bashkëpunimin dhe mbështetjen e dhënë në menaxhimin sa më të mirë të kompanisë.